

KODI I PROCEDURAVE ADMINISTRATIVE

Neni 37 Rastet e skualifikimit

1. Asnje punonjes i organeve te administrates nuk mund te marre pjese ne nje proces vendimmarres administrativ apo ne nje lidhje kontrate ku administrata qe ai perfaqeson eshte pale ne rastet kur punonjesi ka ose/dhe dyshohet te kete kushtet e meposhtme:

- a) Ka nje interes personal direkt apo indirekt ne ceshtjen ne fjale;
- b) bashkeshorti apo bashkejetuesi ose te afermit e tij deri ne shkalle te dyte kane nje interes direkt apo indirekt ne ceshtjen ne fjale;
- c) punonjesi apo personat e parashikuar nga paragrafi b) i ketij neni kane nje interes direkt apo indirekt ne nje ceshtje te ngjashme me ceshtjen ne fjale;
- ç) punonjesi ka marre pjese si ekspert, keshilltar apo avokat ne ceshtjen ne fjale;
- d) personat e permendur ne paragrafin b) te ketij neni kane marre pjese si eksperte, keshilltare apo avokate ne ceshtjen ne fjale;
- dh) kunder punonjesit apo ndaj personave te permendur ne paragrafin b) te ketij neni eshte nisur nje proces gjyqesor nga palet e interesuara;
- e) Ceshtja eshte apelim i nje vendimi te marre prej punonjesit ose nga personat e permendur ne paragrafin b) te ketij neni;
- e) punonjesi ose personat e permendur ne paragrafin b) te ketij neni jane debitore ose kreditore te paleve te interesuara ne nje procedim administrativ apo lidhje kontrate ku administrata publike eshte pale;
- f) punonjesi ose personat e permendur ne paragrafin b) te ketij neni kane marre dhurata nga palet e interesuara ne procedimin administrativ apo ne lidhjen e kontrates perpara ose pas fillimit te procedimit administrativ apo lidhjes se kontrates;
- g) punonjesi ose personat e permendur ne paragrafin b) te ketij neni kane miqesi ose armiqesi me palet e interesuara ne procedimin administrativ apo lidhjen e kontrates.

Neni 38 Deklarimi i rasteve te skualifikimit.

1. Ne rastet kur nje punonjes ndalohet te marre pjese ne nje vendim-marrje apo procedim administrativ, sipas nenit 37, ai duhet te lajmeroje menjehere eprorin e tij ose drejtuesin e organit kolegjial.
2. Deri ne marrjen e nje vendimi te prere, çdo pale e interesuar mund te kerkoje ndalimin e pjesemarrjes se nje punonjesi ne nje vendimarrje apo procedim administrativ, duke parashtruar arsyet per te cilat pala kerkon nje veprim te tille.
3. Eprori ose drejtuesi, kur kemi te bejme me nje organ kolegjial, merr vendim per perjashtimin nga nje vendimarrje apo procedim administrativ te punonjesit qe paraqet rastet e nenit 37.
4. Ne rastet kur behet fjale per perjashtimin e drejtuesit nga nje vendimarrje apo procedim administrativ, sipas nenit 37, vendimi per kete perjashtim merret nga vete organi kolegjial, por pa pjesemarrjen e drejtuesit.

Neni 39 Efektet e skualifikimit

1. Ne rastet e parashikuara nga paragrafet 1 dhe 2 te nenit 38, nepunesi duhet te nderprese çdo veprim per sa kohe eprori nuk urdheron te kunderten.
2. Pavaresisht nga skualifikimi i subjekteve ne rastet e parashikuara nga neni 37, ato subjekte jane te detyruara te ushtrojne kompetencat e tyre ne raste emergjence, me kushtin qe keto veprime te ratifikohen nga subjekti zevendesues ose nga organi kolegjial.

Neni 40 Efektet e deklarimit te skualifikimit

1. Menjehere pas deklarimit te skualifikimit, zyrtari ne fjale zevendesohet nga zevendesi i tij ligjor, pervec rasteve kur eprori e merr kete ceshtje nen autoritetin e tij.
2. Ne rastet e nje organi kolegjial, organi do te funksionoje, si i tille por pa pjesemarrjen e anetarit qe eshte skualifikuar.